



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500535/9

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandohet ushtrimi i autoritetit ndaj qëndrimit të regjistruarve të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme si dhe Kryeregjistruarit të ZQRPP, në procesin e kërkimit prej Institucionit të Avokatit të Popullit të dhënies së informacionit apo shpjegimeve si dhe kthimit të përgjigjes për rekomandimet e adresuara.*

Drejtuar : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë,

TIRANË

I nderuar Z.Ministër!

Në procesin e shqyrtimit të një numri rastesh të prezantuara prej individëve të ndryshëm, Institucioni që unë përfaqësoj, në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, pengohet në ushtrimin e detyrës prej individëve, përfaqësues të organeve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Në mënyrë të parregullt e të përsëritur, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo Kryeregjistruari i ZQRPP, nuk përmbushin detyrimin në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit, sikundër parashikuar në, nenin 63, pika 3, 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 19, pika b, 21, pika b, të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 " *Për Avokatin e Popullit* ", të ndryshuar.

Kjo situatë, konstatohet në rastet si më poshtë prezantuar;

- 1- Moskthim i përgjigjes nga ana e Kryeregjistruarit të ZQRPP, lidhur me kërkesën nr.K3/E14-2 prot, datë 02.06.2015, (përsëritur me shkresat nr. Nr.K3/E14-5 prot, datë 16.11.2015 dhe nr.K3/E14-6 prot, datë 07.03.2016).
- 2- Moskthim i përgjigjes nga ana e Regjistruarit të ZVRPP, Tiranë, lidhur me kërkesën nr.K3/B7-2 prot, datë 27.04.2015, (përsëritur me shkresat nr. nr.K3/B7-6 prot, datë 05.01.2016 dhe Nr.K3/B7-9 prot, datë 07.03.2016).
- 3- Moskthim i përgjigjes nga ana e Kryeregjistruarit të ZQRPP, lidhur me kërkesën nr.K3/T12-2 prot, datë 02.06.2015, (përsëritur me shkresat nr. nr.K3/T12-8 prot, datë 05.08.2015 dhe Nr.K3/T12-16 prot, datë 04.05.2016).

- 4- Moskthim i përgjigjes nga ana e Kryeregjistruesit të ZQRPP, lidhur me rekomandimin e dhënë me shkresën Nr.K3/I52-10 prot, datë 21.03.2016, (përsëritur me shkresën nr. nr.K3/I52-12 prot, datë 04.05.2016).
- 5- Moskthim i përgjigjes nga ana e Kryeregjistruesit të ZQRPP, lidhur me rekomandimin e dhënë me shkresën Nr.K3/S20-8 prot, datë 15.01.2016, (përsëritur me shkresën nr. nr.K3/S20-12 prot, datë 04.05.2016).

Mosrespektimi i detyrimit ligjor nga ana e subjekteve përfaqësues të organeve të lartpërmendura, për kthimin e përgjigjeve rreth kërkesave apo rekomandimeve të dërguara, vjen ndesh me parimin e ligjshmërisë, informimit apo transparencës, sikurse parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, Ligji nr.44/2015, dhe të detyrueshme për zbatim. Kjo situatë e krijuar prej qëndrimit të parregullt prej individëve pranë organeve të sipërcituara, nuk vjen në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “*Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*”.

Për të mundësuar ndërprerjen e qëndrimit të parregullt nga ana e organeve të lartpërmendura, i cili ka çënuar dhe çënon parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, Institucioni i Avokatit të Popullit, mbështetur në parashikimet e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se : “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike*”, si dhe nenin 21/b, se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”.

REKOMANDON

Ushtrimin e autoritetit ndaj qëndrimit të regjistruarve të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme si dhe Kryeregjistruesit të ZQRPP, në procesin e kërkimit prej Institucionit të Avokatit të Popullit të dhënies së informacionit apo shpjegimeve si dhe kthimit të përgjigjes për rekomandimet e adresuara.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të mundësohet bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

- 1- *Kopje të Shkresës Nr.K3/E14-2 prot, datë 02.06.2015, drejtuar Kryeregjistruesit të ZQRPP, si dhe përsëritjes së saj me shkresat nr. nr.K3/E14-5 prot, datë 16.11.2015 dhe Nr.K3/E14-6 prot, datë 07.03.2016.*
- 2- *Kopje të nr.K3/B7-2 prot, datë 27.04.2015, drejtuar e Regjistruarve të ZVRPP, Tiranë, si dhe përsëritjes së saj me shkresat nr. Nr.K3/B7-6 prot, datë 05.01.2016 dhe Nr.K3/B7-9 prot, datë 07.03.2016..*
- 3- *Kopje të shkresës Nr.K3/T12-2 prot, datë 02.06.2015, drejtuar Kryeregjistruesit të ZQRPP, si dhe përsëritjes së saj me shkresat nr.*

Nr.K3/T12-8 prot, datë 05.08.2015 dhe Nr.K3/T12-16 prot, datë 04.05.2016.

- 4- Moskthim i përgjigjes nga ana e Kryeregjistruesit të ZQRPP, lidhur me rekomandimin e dhënë me Shkresën Nr.K3/I52-10 prot, datë 21.03.2016, (përsëritur me shkresën nr. Nr.K3/I52-12 prot, datë 04.05.2016).*
- 5- Kopje të Shkresës Nr.K3/S20-8 prot, datë 15.01.2016, drejtuar Kryeregjistruesit të ZQRPP, si dhe përsëritjes së saj me shkresën nr. Nr.K3/S20-12 prot, datë 04.05.2016.*

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktiligrafoi

A.Gjoleka